Republika e Kosovës - Republika Kosova -
Republic of Kosova
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Sportit dhe Rinisë / Ministarstvo Sporta i Omladine
Ministry of Sport and Youth

Prishtinë, Mars 2026

THIRRJE E HAPUR
për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)

Ministria e Sportit dhe Rinisë (MSR) shpallë thirrje të hapur për përzgjedhjen e përfaqësuesit rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO).

Përfaqësuesi rinor i Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor do të nominohet dhe përzgjidhet nga organizatat e shoqërisë civile, ndërsa procesi do të organizohet nga MSR në bashkëpunim me Platformën CiviKos.

Rreth RYCO-s

Në kuadër të Procesit të Berlinit, gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor 2016 në Paris, është nënshkruar Marrëveshja mbi themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor nga gjashtë vende (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia). Vizioni i RYCO-s është mbështetja e të rinjve si grupi më me interes për të promovuar frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit mes të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit.

Autoriteti më i lartë për vendimmarrje i RYCO-s është Bordi Drejtues, i përbërë nga dy përfaqësues nga secili vend: një përfaqësues nga qeveria dhe një përfaqësues rinor.

Përgjegjësitë e përfaqësuesit rinor në RYCO

Përfaqësuesi/ja i rinor/e në RYCO do të përfaqësoj të rinjtë e Republikës së Kosovës. Ai/ajo do të jetë anëtar/e e Bordit Drejtues të RYCO-s për të punuar me përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës.

Përfaqësuesi/ja rinor/e po do të bashkëpunoj me përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës dhe

përfaqësuesit e tjerë të qeverive dhe të rinjve të rajonit në Bordin Drejtues të RYCO-s. Ai/ajo do të ketë një mandat prej 3 vjetësh, pa mundësi vazhdimi.

Bordi Drejtues ka për detyrë të:

- mbikëqyrë menaxhimin, financat dhe cilësinë e punës, programeve dhe politikave;
- sigurojë avancimin e punës, reputacionit dhe impaktit të RYCO-s në përputhje me misionin e saj;
- caktojë drejtimin strategjik duke kontribuuar dhe miratuar raportet, planet e punës, dokumentet tjera strategjike, dhe;
- bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të sekretariatit dhe monitorojë punën e tyre.

Në mbështetje të përmbushjes së misionit të RYCO-s, përfaqësuesi rinor:

- merr pjesë në mbledhjet e bordit drejtues;
- shqyrton dhe jep mendim mbi dokumentet strategjikë dhe operacionale të RYCO-s dhe çështje të tjera të ndërlidhura që adresohen në mbledhjet e bordit drejtues;
- merr pjesë në aktivitetet e zhvilluara nga RYCO ose Zyra Lokale e Kosovës sipas kërkesës dhe nevojës.

Nominimi

Të drejtë nominimi/kandidimi të përfaqësuesit rinor kanë të gjithë të rinjtë, shtetas të Republikës së Kosovës, dhe të gjitha OJQ-të në Republikën e Kosovës.

CiviKos vetëm e lehtëson procesin e përzgjedhjes dhe të gjithë të rinjtë dhe të gjitha OJQ-të në Kosovë të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuar me këtë thirrje kanë të drejtë nominimi dhe votimi, pavarësisht anëtarësimit në CiviKos.

Kriteret për përfaqësuesin rinor

Kandidatët e rinj të vet-nominuar apo të nominuar nga OJQ-të duhet të plotësojnë këto kritere për të hyrë në listën e ngushtë të votimit:

1. Të jetë shtetas/e i Republikës së Kosovës.
2. Të jetë jo më i ri/e se 18 vjet dhe jo më i/e vjetër së 29 vjeç.
3. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar dhe të demonstroj motivim për të qenë anëtar/e aktiv/e i/e Bordit Drejtues me mandat 3 vjeçar.
4. Të ketë njohuri minimale të gjuhës angleze, ekuivalente të nivelit B2. Njohuri të gjuhëve tjera është përparësi.
5. Të ketë minimalisht 3 vite përvojë veprimi në aktivitete të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbështetjen e zhvillimit të rinisë, promovimin e qytetarisë aktive, promovimin e paqes dhe/apo avancimin e të drejtave të njeriut.
6. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit.
7. Të mos jetë anëtar i partive politike, pjesë e organeve drejtuese apo i forumeve rinore

të tyre dhe organizatave politike.

Dokumentet e kërkuara

- Letërnjoftimi apo pasaporta e skanuar.
- Dëshmi e zotësisë, motivimit dhe njohurisë së gjuhës angleze përmes videos prezantuese e cila nuk duhet të jetë më e gjatë se dy minuta. Videoja duhet të jetë tërësisht në gjuhën angleze dhe t'i përgjigjeni pyetjes: "Përse duhet të jeni ju përfaqësuesi/ja rinor/e i/e Kosovës në Bordin Drejtues të RYCOs?"
- Dëshmi për përvojën e punës jo më pak se 3 vite përmes tri dokumenteve:
    - Rezymesë / CV-së;
    - Portfolios të aktiviteteve, formatin e të cilit e gjeni në njoftimin e thirrjes;
    - Letrës së rekomandimit nga një OJQ e regjistruar në Kosovë e nënshkruar dhe vulosur nga drejtori/esha i/e organizatës apo përfaqësuesi/ja ligjor/e.
- Certifikatë mbi denimet penale nga Platforma E-Kosova e cila dëshmon gjendjen gjyqësore.
- Formular vetëdeklarimi për mosqenien anëtar i partive politike, pjesë e organeve drejtuese apo i forumeve rinore të tyre dhe organizatave politike, i firmosur dhe skanuar, formatin e të cilit e gjeni në njoftimin e thirrjes.
- Autorizim për publikimin e videos prezantuese dhe CV-së të kandidatit në faqet zyrtare dhe medias sociale të MSR-së, formatin e të cilit e gjeni në njoftimin e thirrjes.
- Deklaratë për nominim nga OJQ-të (kjo vlen vetëm për OJQ-të që nominojnë kandidat nga radhët e tyre, nuk vlen për individët që vetkandidojnë).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen nga kandidati/ja i/e vetnominuar apo nga OJQ-ja që nominon një kandidat/e. Dokumentet duhet të dorëzohen me email në votimi.civikos@gmail.com ose me postë në adresën Platforma CiviKos Fazli Grajqevci, Objekti nr.96, H1, 10000 Prishtinë.

Afati për të dorëzuar dokumentet do të jetë i hapur deri me 07.04. 2026, ora 17:00.

Përzgjedhja e kandidatëve

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Ministrisë së Sportit dhe Rinisë (MSR), një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos dhe ish Përfaqësuesi Rinor i Kosovës në Bordin Drejtues të RYCO, znj. Donika Zogu. Në rast të pamundësisë së ish Përfaqësuesit Rinor të merr pjesë, MSR dërgon një përfaqësues të dytë. Paneli do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara.

Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim. Të gjithë kandidatët apo nominimet që nuk i plotësojnë kriteret e lartcekura apo nuk e respektojnë afatin e përcaktuar, nuk do të merren parasysh.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, Platforma CiviKos do të njoftojë publikisht për hapjen e procesit të votimit dhe do të publikojë në faqen e vet të internetit

fletëvotimin zyrtar.

Procesi i votimit

Të drejtë votimi kanë OJQ-të në Republikën e Kosovës. OJQ-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Secila organizatë mund të votojë për një (1) kandidat nga lista e kandidatëve të përfshirë në fletëvotim, sipas parimit 'një organizatë - një votë'.

Rikujtojmë se në rastin e votimit të shumëfishtë nga e njëjta organizatë, votat e saj do të konsiderohen të pavlefshme. Gjithashtu, do të konsiderohet e pavlefshme vota e organizatës, e cila nuk ka ngarkuar dokumentacionin si më poshtë ose ka shkelur afatin e votimit.

Dokumentet që duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur (email apo me postë dhe fizikisht vetëm me datën 09.04.2026 nga ora 09:00 - 17:00) janë:

1. Fletëvotimi, të rrethohet numri rendor i kandidatit/es që votoni.
2. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së.
3. Deklarata e nënshkruar dhe vulosur nga Drejtori/Drejtoresha e OJQ-së, për votim në këtë proces.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhgueseve përfaqësuesit e MSR-së dhe të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e Departamentit për Regjistrim të OJQ-ve.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i vajzave dhe grave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve tjera të nënpërfaqësuara.

Për çfarëdo pyetje rreth këtij procesi të përzgjedhjes, kontaktoni Platformën CiviKos nëpërmjet e-mailit votimi.civikos@gmail.com ose numrit të telefonit 038 224 904.

Për më shumë informacion rreth Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ju lutemi vizitoni https://www.rycowb.org/.

SHTOJCA 1:

Portofolio e punës dhe përvojave në shoqëri civile

Ju lutemi që brenda një faqe A4 të dëshmoni 3 vite përvojë veprimi në aktivitete të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbështetjen e zhvillimit të rinisë, promovimin e qytetarisë aktive, promovimin e paqes dhe/apo avancimin e të drejtave të njeriut.

Shembull:

- Emri i organizatës ku jeni angazhuar/ apo iniciativa vullnetare:
- Detyrat e punës/ apo angazhimi në organizatë:
- Referenca/dëshmia: *web faqe/media sociale dhe/apo kontakti i personave që dëshmojnë angazhimin më lartë.*

Shënim: shtoni të tjera përvoja sipas nevojës

Emri dhe mbiemri

_____

Nënshkrimi

SHTOJCA 2:

Deklaratë për përmbushjen e kritereve për nominim për përfaqësuesin rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)

Data:

Unë, i nënshkruari, _____, me numër personal _____ i lindur më (data e lindjes) _____, në _____ (vendi i lindjes), deklaroj me vullnet të lirë se plotësoj kriteret e mëposhtme për aplikim për përfaqësuesin rinor të Kosovës në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) si :

1. Nuk jam i/e dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit.
2. Nuk jam anëtar/e i/e partive politike, pjesë e organeve drejtuese apo i forumeve rinore të tyre dhe organizatave politike.
3. Autorizoj publikimin e videos prezantuese në faqet zyrtare dhe medias sociale të MKRS-së dhe CIVIKOS.

Emri dhe mbiemri

_____

Nënshkrimi